



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivered	26-08	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKRPTSHK	5002/2022		019	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.619/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arditë Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bektëshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.619/2022 të datës 14.07.2022 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ më adresë \_\_\_\_\_ kundër shkresës/Vendimit 02 Nr.111/2022 të datës 29.06.2022 të Komisionit të Pranimit në kuadër të Komunës së Istogut, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 26.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet pjesërisht si e bazuar* ankesa me numër A.nr.619/2022 e datës 14.07.2022 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ lidhur me kontestimin e kompetencës së Komisionit të Pranimit si dhe *Shfuqizohet* akti me numër reference 02Nr.111/2022 i datës 29.06.2022 i Komisionit të Pranimit në kuadër të Komunës së Istogut.
- II. *Refuzohet* pretendimi ankimor lidhur me shfuqizim e Vendimit Nr.106/022 të datës 23.06.2022 të Menaxherit të Personelit të Komunës së Istogut, *i njëjti vërtetohet*.

A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ më datë 14.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4117/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër aktit/Vendimit me numër reference 02 Nr.111/2022 të datës 29.06.2022 të Komisionit të Pranimit në kuadër të Komunës së Istogut, për shkak të cenimit të dispozitave materiale, shkeljes së dispozitave procedurale dhe konstatim të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Istogut. Ndërsa, Këshilli më datë 25.07.2022 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në ankesë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokollit 4117/2022 të datës 14.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër Reference RN00008904 të datës 28.04.2022 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit; Vendimin me numër 02 Nr.106/022 të datës 23.06.2022 të Menaxherit të Personelit të Komunës së Istogut; Vendimin me numër 02Nr.111/2022 të datës 29.06.2022 të Komisionit të Pranimi në kuadër të Komunës së Istogut; Licencën e mësimdhënies me Nr.1026284 për ankuesin; Diplomën me Nr. 1610 për ankuesin; Certifikatën për periudhën 12-14.10.2021; Certifikatën e datës 23.10.2018; Certifikatën për periudhë 03-04.07.2017; Certifikatën për periudhën 15-19.05.2019 dhe 06-08.06.2017; Certifikatën për periudhën 03-04.08.2016; Certifikatën për periudhën 03-04.03.2016; Certifikatën nëntor 2006; Certifikatën e datës 28.02.2003; Shkresën nga IOM; Certifikatën për periudhën 24.09-05.10.2001; Certifikatën për periudhën 14-17.12.2015; Vërtetimin me Nr. Pr.208/1 i datës 25.01.2013; Vërtetimin me Nr. 09 i datës 21.01.2013; Shkresë Zyrtare e datës 10.05.2022; Vërtetimin me Nr. 192 i datës 10.04.2006; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës për vitin 2020 dhe 2021; Certifikatën e datës 13.05.2022 nga Gjykata Themelore në Pejë-Dega Istog; Vërtetimin e datës 10.05.2022; Certifikatën e Lindjes me Nr. L 24605318; Certifikatën për periudhën 06-07.12.2001; Dokumentin për verifikim paraprak e datës 26.05.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 25.07.2022; Dokumentet e dorëzuar nga ankuesi me rastin e aplikimit për konkursin, emailat e datës 25.08.2022 nga KPSHCK dërguar ankuesit për prova shtesë, e mailin e datës 25.08.2022 të ankuesit në përgjigje të kërkesës së KPSHCK-së sipas emailit të datës 25.08.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së është e pabazuar ankesa e ankuesit, **sepse:**

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rrjedhë së Komuna e Istogut më datë 28.04.2022 ka publikuar Njoftimin për shpallje të Konkursit me numër Reference RN00008904 për lëvizjes brenda kategorisë për pozitën *Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit*, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. I njëjti në bazë të dokumentit për verifikimin paraprak të lëshuar nga Menaxher i Personelit i Komunës së Istogut është përfshirë në listën e kalueshmërisë së verifikimit paraprak, ndërsa në bazë të Vendimit me numër 02 Nr.106/022 të datës 23.06.2022 të Menaxherit të Personelit ankuesi i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin që nuk ka dy vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura.

Ankuesi kundër Vendimit me numër 02Nr.106/022 të datës 23.06.2022 të Menaxherit të Personelit, ka parashtruar ankesë më datë 28.06.2022, ndërsa Komisioni i Pranimi me aktin me numër reference 02 Nr.111/2022 të datës 29.06.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të bazuar, po me arsyetimin së ankuesi nuk ka përvojën e punës së kërkuar për pozitën e shpallur.

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Zyra e Personelit ka nxjerr vendime kundërthënës sepse fillimisht merr vendim se kam kaluar me sukses verifikimin paraprak e me pastaj nxjerrë një vendim tjetër se nuk kam kaluar verifikimin paraprak, dhe se Komisioni i pranimit tejkalon kompetencën e vet për shkak se i njëjti benë vlerësim që është në kompetencë të zyrës së personalit dhe ky veprimi i

komisionit bie ndesh me nenin 16 të Rregullores 16/2020 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Propozon që Këshilli të anuloj Vendimin 02Nr.106/022 të datës 23.06.2022 të Menaxherit të Personelit, si dhe aktin/vendimin me numër reference 02 Nr.111/2022 të datës 29.06.2022 të Komisionit të Pranimit dhe ankuesit ti lejoj vazhdimin e procedurës së konkursit.

Në përgjigjen në ankesë, Menaxheri i Personelit të Komunës së Istogut thekson se gjatë verifikimin paraprak të dokumentacionit Zyra e Personelit ka lëshuar një gabim tek vlerësimi i përvojës së punës profesionale në fushën përkatës dhe si rrjedhojë e këtij gabimi ankuesi është futur gabimisht në listën e ngushtë, me c' rast me vonë në konsultim edhe me Komisionin e Pranimit është konstatuar së i njëjti nuk mund të vazhdoj me tej këtë procedurë pasi nuk plotëson kriterin e përvojës profesionale për lëvizje brenda kategorisë.

Lidhur me pretendimin ankimor se Komisioni i Pranimit nuk ka qenë kompetent për vendosje të ankesës së ankuesit të parashtruar kundër Vendimit 02 Nr.106/022 të datës 23.06.2022 të Menaxherit të Personelit, Kolegji ju referua nenit 15 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin është përcaktuar se: *Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, ë përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njësisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj, rrjedhimisht në kuptim të këtyre normave ligjore rezulton se organ/njësi përgjegjëse për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesat e parashtruara në fazën e shqyrtimit paraprak është Zyra e Burimeve Njerëzore e institucionit përkatës, e mbi këto arsye, Kolegji konstaton se Komisioni i Pranimit të Komunës së Istogut ka tejkaluar autorizimet gjegjësisht kompetencat ligjore me rastin e vendosjes lidhur me ankesën e ankuesit të parashtruar kundër refuzimit të aplikacionit, kështu që mbi bazën e këtij konstatimi Kolegji ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.*

Sipas Konkursit për lëvizje brenda kategorisë, me numër reference RN00008904, për pozitën e punës *Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit* si kushte të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimi i kërkuar:** *Diplomë/a të studimeve universitare, Drejtimet në Inxhinieri Mjedis, Mbrojtje e Ambientit apo Mjedisit, Kimi e Përgjithshme, Ekologji, Biologji, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku dy (2) vite përvoja pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së listë të punës”,* ndërsa bazuar në analizimin e dokumentacionit të ankuesit Kolegji ka gjetur se lidhur me fushën e arsimit ankuesi posedon: Diplomën me Nr.1610 të datës 18.10.2017 të lëshuar nga Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me të cilën dëshmohet se i njëjti me datë 09.11.1992 ka përfunduar studimet themelore në Departamentin e Përgjithshëm të Kimisë duke marr titullin Profesor i Kimisë si dhe Licencën e mësimdhënësit me nr.1026287 të datës 25.05.2018, kurse lidhur me kriterin e përvojës së punës ankuesi posedon: Vërtetimin Nr.pr.208/1 të datës 25.01.2013 të lëshuar nga Shkolla Teknike e Mesme "Mithat Frashëri" në Gurakoc-Istog, me të cilën dëshmohet se ankuesi nga data 01.09.1995 deri më datë 01.09.1997 ka qenë në marrëdhënie pune në këtë shkollë si profesor, Vërtetimin Nr.09 të datës 31.01.2013 të lëshuar nga Shkolla Nëntëvjeçare "Bajram Curri" në Istog, me të cilën dëshmohet se ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune në këtë shkollë nga data 26.09.1997 deri më datë 31.08.1998 si mësues klase, ndërsa në bazë të Shkresës Zyrtare të datës 10.05.2022 të lëshuar nga Udhëheqësi i Njësisë për Punë Juridike dhe të Përgjithshëm në Qendrën Korrektuese në Dubravë, dëshmohet që ankuesi nga data 24.09.2021 është në marrëdhënie pune në këtë qendër në pozitën Zyrtar për Punë Sociale, andaj duke marr për bazë të gjitha dëshmitë e përvojës së punës se ankuesit të administruara si me lartë, Kolegji konstaton që ankuesi nuk ka



arrit të provoj së i njëjti ka përvojë dy vjeçare të punës profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura, gjegjësisht në kuptim të vërtetimit të kriterit lidhur me përvojën e punës së ankuesit Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 86 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e me qëllim të zgjidhjes së drejt dhe të ligjshme të kësaj çështje juridike-administrative, ex officio ka kërkuar prova shtesë nga ankuesi dhe rrjedhimisht ankuesi përveç deklaratimit me shkrim se ka qenë profesor i lëndës së kimisë në Shkollën e Mesme Teknike " Mithat Farshëri" në Istog, nuk ka siguruar asnjë dëshmi tjetër plotësuese si kontratë punë apo vërtetim nga institucioni mësimor, kështu që nisur nga këto rrethana, Kolegji konstaton se janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit së ankuesi plotëson kriteret e konkursit për pozitën e *Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit* në Komunën e Istogut, e mbi bazën e këtij konstatimi Kolegji ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Nisur nga të gjeturat dhe rrethanat si me lart, Kolegji i Këshillit konstaton së Menaxheri i Personelit të Komunës së Istogut me rastin e nxjerrjes së Vendimit 02 Nr.106/022 të datës 23.06.2022, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe e ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbrojtës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### **Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

### **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS** Lënda me numër A.nr.619/2022

**Avdyl BEKTESHI**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Kryetare e Kolegjit*



#### **Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Istogut;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Istogut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

